



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Me datë: 21.09.2016

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

SHPALL KONKURS

Për angazhimin e personelit akademik në Fakultetin e Sigurisë Publike, për vitin akademik 2016/2017

I. Drejtimi: Policia dhe Inspektorati Policor

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Siguria Kombëtare	dimëror
2.	Menaxhimi i Organizatave të Policisë	veror
3.	Policimi dhe Autorizimet Policore	veror
4.	Menaxhimi i Trafikut	dimëror
5.	Menaxhimi i Sigurisë Publike	dimëror
6.	Menaxhimi i Krizave	dimëror
7.	Krimet Financiare	veror

II. Drejtimi: Doganor

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Institucionet Globale dhe Tregtia Ndërkombëtare	veror
2.	Doganat e Kosovës	veror
3.	Kuptimi dhe historia e klasifikimit të mallrave	veror
4.	Klasifikimi i mallrave dhe njohja e mallrave	veror
5.	Teknikat e klasifikimit	veror
6.	Eksporti i mallrave	dimëror
7.	Importi i mallrave	dimëror
8.	Procedura doganore me ndikim ekonomik	dimëror
9.	Përjashtimet nga detyrimet e importit	dimëror
10.	Fushat e tjera të kontrollit dhe zbatimi i ligjit në Dogana	veror
11.	Klasifikimi i mallrave me akcizë	veror
12.	Klasifikimi i mallrave me shkallë zero	veror
13.	Kontrolli i trafikut rrugor	veror
14.	Kontrolli i trafikut ajror dhe pasagjereve	veror

15.	Përpunimi i brendshëm doganor dhe përpunimi nën kontrollin doganor	veror
16.	Magazinimi doganor	veror

Lëndët me numër rendor nga 11 deri 16 janë lëndë zgjedhore, andaj kontrata do të lidhet me mësimdhënësin vetëm nëse lënda zgjidhet nga studentet.

III. Drejtimi: Menaxhimi Emergjent

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Aplikimi i teknologjisë informative në Menaxhimin Emergjent	veror
2.	Bazat e Menaxhimit Emergjent	veror
3.	Gatishmëria Emergjente	veror
4.	Planifikimi, gatishmëria dhe reagimi në fatkeqësitë me materie të rrezikshme	veror
5.	Vendim-marrja dhe zgjidhja e problemeve në Menaxhimin Emergjent	veror
6.	Sistemi i integruar i Menaxhimit Emergjent	veror
7.	Parandalimi, identifikimi, analizimi dhe menaxhimi i rreziqeve	dimëror
8.	Dizajnimi i ushtrimeve	dimëror
9.	Rimëkëmbja nga fatkeqësitë	dimëror
10.	Çështja e shëndetit publik në Menaxhimin Emergjent	dimëror
11.	Planifikimi Kontingjent	dimëror
12.	Teknikat e shuarjes dhe shpëtimit nga zjarri II	dimëror
13.	Teknikat e shuarjes dhe shpëtimit nga zjarri I	veror
14.	Instrumentet e Sigurisë nga zjarri	veror

Lëndët me numër rendor 11 deri 14 janë lëndë zgjedhore, andaj kontrata do të lidhet me mësimdhënësin vetëm nëse lënda zgjidhet nga studentet.

IV. Drejtimi: Shërbimi Korrektues dhe Sprovues

Nr.	Lëndët	Semestri
1.	Siguria dhe Menaxhmenti	veror
2.	Teknikat dhe taktikat mbrojtëse	dimëror
3.	Vlerësimi i rrezikut	veror
4.	Puna në komunitet	veror
5.	Menaxhimi i situatave emergjente	veror

Lënda me numër rendor 5 është lëndë zgjedhore, andaj kontrata do të lidhet me mësimdhënësin vetëm nëse lënda zgjidhet nga studentet.

Konkursi është intern (brenda institucioneve të sigurisë) andaj të drejtë aplikimi kanë vetëm zyrtaret e punësuar në institucionet e sigurisë publike, si: Policia e Kosovës, Inspektorati i Policisë së Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent e Kosovës, Shërbimi Korrektues dhe Sprovues të Kosovës.

Zyrtaret e Institucioneve të Sigurisë, mund të aplikojnë vetëm në lëndën/lëndët nga drejtimi sipas institucionit punëdhënës, shembull: për lëndët nga drejtimi Policia dhe Inspektorati Policor mund të aplikojnë vetëm zyrtaret e Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës të cilët plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatet e interesuar duhet të kenë gradë shkencore se paku master/magjistraturë apo ekuivalent.

Përzgjedhja e personelit të angazhuar do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kompensimi për personelin e angazhuar (me honorar) do të bëhet vetëm për orët e mbajtura, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr.25/2013 për Pagesat e personelit Trajnues dhe Mësimdhënës si dhe Eksperteve të fushave Funktionale.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim (të specifikohet lënda për cilën aplikon);
- Një cv profesionale;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kontratën e punës dhe një vërtetim se i njëjti ende është në marrëdhënie pune në Institucionin e Sigurisë.
- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Si dhe informata tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr.01.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **7 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën **27.09.2016**, në ora 16:00.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve, do të njoftohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për angazhim me honorar.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210, prej orës 08:00 - 1600.